



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 554/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të BPrAL Kolegji “AAB” për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
 - Dizajn i Modës, BA, 180 ECTS, maksimumi 120 studentë për vit akademik;
 - Dizajn Grafik dhe Art Vizuel, BA, 180 ECTS, maksimumi 120 studentë për vit akademik.
- II. Akreditohet programi i studimit i BPrAL Kolegji “AAB” për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018:
 - Radiologji, BSc, 180 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
- III. Nuk ri/akreditohet programi i studimit i BPrAL Kolegji “AAB”:
 - Menaxhim Sektorial, MSc, 120 ECTS (me specializime: Menaxhimi i Sektorit të Shëndetësisë; Menaxhimi i Sektorit të Kulturës; Menaxhimi i Sektorit të Arsimit; Menaxhimi i Sektorit të Sportit).
- IV. Obligohet BPrAL Kolegji “AAB” që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- V. Obligohet BPrAL Kolegji “AAB” që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji "AAB" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit: Dizajn i Modës, BA, 180 ECTS, Dizajn Grafik dhe Art Vizuel, 180 ECTS, Radiologji, BSc, 180 ECTS, dhe Menaxhim Sektorial, MSc, 120 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Dizajn i Modës	BA	180	Albulena Borovci, Diba Celina, dhe Dita Ethem
2	Dizajn Grafik dhe Art Vizuel	BA	180	Agon Nimani, Besim Mikullovc, dhe Faton Kurti
3	Radiologji	BSc	180	Izet Sadiku, Veprim Shehu dhe Daut Gorani
4	Menaxhim Sektorial	MSc	120	Xhavit Rexhaj, Faton Hoxha dhe Luan Jaha

AKA ka organizuar vizitë në Kolegjin "AAB" më 26.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Ulrike Beier, Markus Paulmichl, Dietmar Paier, Bruce Brown, dhe Adrian Stan.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit "AAB", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për sa i përket programit të studimit Menaxhim Sektorial, MSc, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qarë në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve arsyeshmëria e programit të studimit nuk është plotësisht e bindshme. Sipas tyre ani pse programi ofron katër specializime, nuk është gjetur ndonjë dëshmi se të katër specializimet janë të nevojshme me të vërtetë dhe se kjo bëhet edhe me e qartë kur shikohen shifrat e studentëve të regjistruar në secilin drejtim.

Ekspertët kanë mësuar se në Raportin e Vet Vlerësimi ka disa mangësi për sa i përket plan programit. Në raport mungon krejtësisht koncepti gjithëpërfshirës didaktik dhe se ky koncept duket se zhvillohet në masë të madhe në mënyrë joformale. Ani pse syllabuset dërgohen në këshillin e fakultetit nga profesorët për vlerësim, nuk është bërë e ditur se cilat janë parimet didaktike që aplikohen gjatë vlerësimit të syllabusëve. Po ashtu ekspertët kanë theksuar se përshkrimi i lëndëve ka nevojë të përmirësohet pasi që disa lëndë nuk kanë objektiva të përcaktuara mirë të mësimit.

Mënyra se si është bërë llogaritja e ECTS-ve ka qenë e paqartë për ekspertët dhe se bartësit e programit nuk kanë arritur të shpjegojnë mirë së si bëhet kalkulimi i ngarkesës. Sipas ekspertëve, institucioni duhet të përdorë një skemë të standardizuar për kalkulimin e ECTS-ve dhe kjo duhet të përdoret për të gjitha lëndët dhe studentët.

Për sa i përket punës kërkimore dhe bashkëpunimit ndërkombëtarë, ekspertët nuk kanë mësuar për asnjë bashkëpunim ndërkombëtarë në fushën e hulumtimit për këtë program të studimit. Ekspertët kanë mësuar gjatë takimeve që nuk ka asnjë program të rregullt të hulumtimit apo ndonjë skemë të rregullt për financimin e brendshëm të projekteve hulumtuese për stafin akademik.

Përfundimisht ekspertët kanë deklaruar se raporti i vet vlerësimit përmban mangësi dhe këto mangësi nuk kanë arritur të shpjegohen mirë gjatë vizitës për akreditim.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji “AAB”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë